

Njoftim për media

KONFERENCË PËR SHTYP NË LIDHJE ME PUBLIKIMIN E RAPORTIT PËR MONITORIMIN E ZRRE-së NË KEK

PRISHTINË, 6 SHTATOR 2006, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) njofton se të enjten me 07 shtator 2006, duke filluar nga ora 10:00, në objektin e zyrave të saj (Rruga Hamdi Mramori Nr.1 mbrapa Muzeut të Kosovës), do të mbajë konferencë për shtyp në lidhje me Publikimin e Raportit për Monitorimin e kryer në KEK, gjatë muajve maj dhe qershor 2006.

Këtë monitorim ZRRE-ja e ka kryer duke u bazuar në mandatin e saj të dhënë nga legjislacioni primar për energji (Ligji për Rregullatorin e Energjisë, 2004/9 dhe Ligji për Energjinë Elektrike, 2004/10). Qëllimi i këtij monitorimi ka qenë vlerësimi i masave të ndërmarra nga KEK-u për zbatimin e dispozitave të kornizës rregullative e që kanë për synim ngritjen e cilësisë së shërbimit dhe përmirësimin e marrëdhënieve me konsumatorët, duke ngritur besimin e tyre e që si rezultat do të kishte edhe ngritjen e arkëtimit për energjinë e furnizuar.

Pas një prezantimi të shkurtër të këtij raporti gazetarët do të kenë mundësi të shtrojnë pyetjet dhe komentet e tyre, ndërsa raporti i plotë do të publikohet prej 6 shtatorit 2006 në ueb-faqen e ZRRE-së www.ero-ks.org/Publications.

Për më shumë informata ju lutemi të kontaktoni:

Adelina Murtezaj

Tel: +381 38 247 615 ext. 101

Fax: +381 38 247 620

Email: adelina.murtezaj@eumik.org